



Në bazë të nenit 11, të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollor nr. 02/2016, të datës 12.01.2016, Gjimnazi " JETA E RE" në Suharekë bën:

## **FTESË PËR OFERTË – Nr. 01/2022**

### **Për ekskursionin e maturantëve të Gjimnazit "JETA E RE" në Suharekë**

Ekskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë ndërmjet datave 25 prill – 30 prill 2022.

Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 (katër) pansione të plota.

Në ekskursion do të marrin pjesë 285 nxënës.

Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit, transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe kala që parashihen në rrugëtimin e ekskursionit.

Operatorët Ekonomik - Agjencionet turistike që konkurrojnë duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. OE duhet të ketë lejen e punës dhe të jetë i licencuar me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit – Ofertës t'i bashkëngjiten fotokopjet e këtyre dokumenteve (të vërtetuara te Noteri).
2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore – Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për këtë për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit.
4. Për tërë personat e angazhuar në ekskursion nga OE (shofer dhe konduktor) duhet të paraqiten certifikatat e mjekut.
5. OE duhet të siguron përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës, diploma dhe kontrata me mjekun, për kohëzgjatjen e ekskursionit.
6. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të mënjanon shpejtë prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose nëse është e nevojshme pa vonesë ta zëvendëson atë.
7. Të ofron dëshminë për rezervimin e hapësirave hoteliere në Durrës, si dhe licencën e akreditimit të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
8. Afati i konkurrimit 7 ditë pune nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
9. Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
10. Formulari i Paraqitjes së Ofertës dhe Rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli drejtues i shkollës merren në Gjimnazin "JETA E RE" në Suharekë nga data 08.04.2022.
11. Dorëzimi i ofertave bëhet deri më 19.04.2022 në ora 14.00, në zyrën pritëse të Qendrës për shërbime qytetare në Suharekë.
12. Hapja e ofertave bëhet me datë 19.04.2022 në ora 15.00 në DKA në Suharekë.
13. Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Vërejtje:

Jashtë kërkesave të kësaj ftese për ofertë asgjë tjetër nuk krijon përparësi për tu përzgjedhur ofertë fituese.

Suharekë, më 08.04.2022



Drejtori, Fadil Elshani, prof.